



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 2065/1 Prot.

Tiranë, më 20.11.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1782, datë 18.11.2015.

SHOQËRISË “LALA-06” SH.P.K
Rruga Elbasan-Metalurgji, km 6, Ndërmarrja e Seleksionimit Mineraleve, Elbasan

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë. ✓

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “LALA-06” sh.p.k, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1782, datë 18.11.2015, për mineralin Hekur Nikel, në objektin “Plasë”, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.889, datë 22.02.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.2065, Prot, datë 23.02.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1782, datë 18.11.2015, për mineralin Hekur Nikel, në objektin “Plasë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, sepse nuk keni respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesat e garancive financiare të rehabilitimit për vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1782, datë 18.11.2015, për mineralin Hekur Nikel, në objektin “Plasë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit **Nr.1782, datë 18.11.2015, për mineralin Hekur Nikel, në objektin “Plasë”, Bashkia Korçë, Qarku Korçë.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

